



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.5.2023

Nr: 477

Ora: 13:30

**VENDIM
PËR**

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT
VETËDEKLARUES Z.DEJSON BEHAR KUQJA, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK
TË BASHKISË ELBASAN, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR PARTIA “BINDJA
DEMOKRATIKE”**

Sot më datë 10.5.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Dejson Behar Kuqja, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, të Bashkisë Elbasan, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Bindja Demokratike”.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 5 dhe 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte

Data: 10.5.2023 Nr: 477
Ora: 13:30



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Dejson Behar Kuqja, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, të Bashkisë Elbasan, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Bindja Demokratike”.

ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak.

Me vendim të KQZ-së, z. Dejson Behar Kuqja, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin e Bashkisë Elbasan, i propozuar nga subjekti zgjedhor partia “Bindja Demokratike”.

Për këtë kandidat në datën 28.3.2023, pranë KQZ është depozituar formulari e vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik EL-BD-5918. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB). Në përgjigje të kësaj kërkesë të KQZ-së, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet komunikimit elektronik ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Dejson Behar Kuqja, ku konstatohet se kandidati në fjalë nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Dejson Behar Kuqja, rezultojnë:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues nuk ka deklaruar gjenealitete të mëparshme.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, Pyetjes 3 “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar: “Policia kufitare Francë, muaji qershor 2021, Kalim i paligjshëm kufiri Francë-Angli”, deklaron se është shpallur i pafajshëm.
- Pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar: “Policia kufitare Francë, muaji qershor 2021, Kalim i paligjshëm kufiri Francë-Angli”, deklaron se është shpallur i pafajshëm.
- Pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar: “Francë, kalim kufiri 1 vit, revokuar.
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar : Se ka jetuar në Itali, “Turizëm 3-4 muaj Romë”, Francë “Turizëm 2-3 muaj Nicë”.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, KQZ çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii)”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i

Data: 10.5.2023 Nr: 477
Ora: 13:30



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Dejson Behar Kuqja, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, të Bashkisë Elbasan, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Bindja Demokratike”.

Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Dejson Behar Kuqja, kandidat për anëtar në këshillin Bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor partia “Bindja Demokratike”, për Bashkinë Elbasan dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 10.5.2023 Nr: 477
Ora: 13:30



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Dejson Behar Kuqja, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, të Bashkisë Elbasan, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Bindja Demokratike”.